

Geschäfts- und Koordinationsstelle

Schlüsselberg 15

Postfach

4001 Basel

Tel. 061 261 22 28

Fax 061 261 22 37

Postkonto 40-5489-7

info@begleitetebesuchstage-baselstadt.ch

IDETË KRYESORE

Edhe atëherë kur prindërit ndahen me njëri tjetrin, përgjegjësia për mirëqenien e fëmijëve mbetet e të dyve.

- **Fëmijët i duan dhe kanë nevojë për të dy prindërit.**
Kjo e vërtetë duhet të respektohet nga ana e të dy prindërve.
- **Secili fëmijë ka të drejtë, ta mirëmbajë lidhjen me të dy prindërit.**
- **E mira e fëmijës është në interesin e të dy prindërve.**
- Për këtë arsye rregulla të qarta për të drejtën e vizitave janë shumë të rëndësishme dhe ju japin siguri të gjithëve .
- **Prindërit që grinden në mes veti, fëmijën e sjellin në një konflikt lojaliteti.**
- Atëherë fëmija nuk mundet me qenë i hapur me prindërit.
- **Para dhe mbas ditës së vizitës fëmijët kanë nevojë për më shumë ndjeshmëri dhe vëmendje të veçantë.**
- **Për përgaditjen dhe strukturën e një vizite,** Përgjegjësia qëndron si te nëna ashtu edhe tek babai.
- **Mosmarrëveshjet në mes të prindërve,** nuk lejohen të zgjidhen para fëmijëve.
- **Grupi përcjellës** është përgjegjës për mbrojtjen dhe të mirën e fëmijës. I ndihmon prindërit dhe fëmijët në organizimin e vizitës brenda kohës së takimit.
- Grupi përcjellës qëndron dhe është i detyruar **të mbaj sekret atë që di.** Sillet neutral dhe nuk ju ofron ndihmesë terapeutike.
- **Grupi përcjellës i vënë në detyrë për të drejtën e vizitës** ka të drejtë të ju jap informacione vendeve me detyra të cakluara sociale, në qoftëse ky grup vëren diçka në sjelljen e fëmijës kundrejt prindërve dhe / ose nëse ndodh diçka në kundërshtim në të mirën e fëmijës.

RREGULLAT

- Gjatë kohës së vizitës **nuk lejohet të delet jashta lokaleve të shtëpisë së ditës (Tagesheim).**
- Ndalohet alkoholi dhe droga
- (Pirja e duhanit bëhet në marrëveshje me grupin)
- Përgaditja e shujtave ditore, larja (e enëve) dhe rregullimi bëhen **në prani** të prindërve dhe të fëmijëve.
- Për shujtën e orës 16.00 (zamër) dhe në përgjithësi shpenzime tjera, paguan në **fund të vizitës vetë prindi Fr. 30.-** (me faturë).
- **Dhuratat** lejohen të sillen vetëm pasi të jenë marrë veshë me palën tjetër të prindit. Mënyra e dhënjes së dhuratës duhet të bisedohet me kujdestaren e fëmijës.
- **Shfrytëzimi i telefonit mobil** është i ndaluar. Në raste të domosdoshme mund të shfrytëzohet telefoni i shtëpisë ditore (Tagesheim)
- **Nuk lejohet të fotografohet.** Sigurimi aksidental dhe detyrim zhdëmtimi (**Unfall- und Haftpflichtversicherung**) u përket pjesëmarrësve.
- Në shtëpinë ditore Tagesheim në rrugën Reb-gasse është e mundur të shfrytëzohet **kopësh-ti** për të lozur. Ju lutemi keni kujdes motin, që fëmija të veshet simbas motit. (eventualisht të sillen rroba shtesë).
- Fëmijët sjellin me vete pantofël.
- Fëmijët lejohen të marrin me vete **lojërat e veta dhe/ose material për punëdore.**
- **Lajmërimet** më së voni bëhen deri të premtën në ora 12.00 në Sekretariat-in pro juventute në këtë numër:
Telefon 061 261 22 28
Fax 061 261 22 37
E-mail: info@begleitetebesuchstage-baselstadt.ch

Në rastë sëmundjeje në ditën e vizitës mund të thirrni drejtëpërdrejtë në **Tagesheim** në Rebgasse 38 , në mes të orës 12.30 dhe 13.00

Telefoni 061 683 94 00